

Nr.

Prot.

Tiranë ___/___/2024

Nr.Dok.202400236/6

Lënda: Rekomandim për garantimin e të drejtave të fëmijëve në situatat e emergjencës nga fatkeqësitë natyrore

BASHKISË SKRAPAR

SKRAPAR

Për dijeni:

AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), bazuar në pikën 1, të nenit 60, të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Ymer Sulaj.

Shtetasi Sulaj është babai i tre fëmijëve, dy prej të cilëve kanë probleme të shëndetit mendor. Ai jeton në një fshat të Njësisë Administrative Gjerbës në kushte shumë të vështira social-ekonomike dhe në një banesë e cila është tërësisht e amortizuar si pasojë e kushteve klimatike, bazuar kjo edhe në fotot e derguara bashkëlidhur ankesës.

Kjo ndërtesë është ndërtuar në vitin 1960-1970 me mure guri dhe mbulesë çatie me rrasa guri. Banesa është e dëmtuar në të gjithë strukturën e saj të mureve të gurit, ku me sy të lirë shikohet çarja e tyre si në fasadën e jashtme por dhe muret brenda banesës. Ndërsa,

çatia e saj është e rrënuar tërrësisht. Shtëpia e z.Sulaj ndodhet në fshatin Zaloshnje në Njësinë Administrative Gjerbës. Ky është një fshat malor, në shpatin e malit të Tomorrit ku në stinën e dimrit rreshjet e dëborës bien me sasi të mëdha. Vetitë mekanike të shtresës së borës (lagështia, trysnia, era) janë elementë që kanë passjellë dëmtimin e çatisë dhe mureve të strukturës së banesës së z.Sulaj.

Të ardhurat e tij janë nga programi i mbrojtjes sociale, skema e ndihmes ekonomike dhe puna që kryen në bujqësi. Bashkia e ka mbështetur me një fond prej 300 000 lekë (treqindmijë) për riparimin e banesës, e cila është shembur në nëntor të vitit 2023. Kjo shumë ka qënë e pamjaftueshme për ristrukturimin e banesës bazuar në vlerësimin e dëmeve të shkaktuara, ç’ka ka sjellë si pasojë pamundësinë për të banuar në këtë banesë, sidomos në periudhën e dimrit.

Fëmijët kanë nevojë për hapësira të sigurt ku mund të gjejnë strehim, mbështetje psiko-sociale dhe një ndjenjë normaliteti. Aq më tepër kur bëhet fjalë për fëmijë me aftësi të kufizuar, si në rastin konkret, të cilët janë më të ekspozuar dhe më vulnerabël ndaj rreziqeve që sjell prishja e banesës, si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Sipas neneve 27 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe nenit 20 të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, çdo fëmijë ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës. Shtetet dhe më konkretisht, sipas ligjit shqiptar, organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe **banimin**.

Bazuar në nenin 30 të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, pika 1/ ç), bashkitë “ç) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin

vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi”, ndërsa në nenin 14, pika 3 specifikohet se “3. Planet për emergjencat civile marrin në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të shtresave në nevojë dhe grave.”

Referuar nenit 13, të ligjit nr. 8454/1999, AP-ja filloi hetimin administrativ të rastit bazuar në ankesën e shtetasit Ymer Sulaj, duke kërkuar informacion zyrtar nga Bashkia Skrapar¹.

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/Y1-2prot., datë 29.02.2024, “*Kthim përgjigje*”, Bashkia Skrapar ka sqaruar si më poshtë vijon:

“...Pranë Bashkisë Skrapar është protokolluar shkresa e Njesisë Administrative Gjerbës, nr.102, datë 13.11.2023, “kërkesë për rikonstrukcionin e çatisë së banesës, së qytetarit Ymer Sula”, protokolluar në institucionin tonë me nr. 3046, datë 14.11.2023. Menjëherë, Kryetari i Bashkisë ngriti një komision me urdhër nr.488, datë 16.11.2023 “Për ngritjen e komisionit për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, në banesën e z.Ymer Sula, fshati Zaloshnje, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar”.

Në datën 17.11.2023 Komisioni shkoi në banesën e qytetarit Ymer Sula, nga ku konstatoi se dëmet ishin të konsiderushme, të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur nga ky komision. Gjithashtu komisioni ka hartuar një preventiv vlerësimi të banesës që është në shumën prej 935 019 (nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë.

Në pamundësi financiare, për ti dhënë të gjithë vlerën e parashikuar në preventiv, me vendim nr.33, datë 23.11.2023, të Këshillit të Bashkisë “Për dhënien e ndihmës financiare, për fatkeqësitë natyrore në banesën e familjes së z.Sulaj, fshati Zaloshnjë, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar” u miratua dhënia e ndihmës financiare prej 300 000 (treqind mijë) lekë për ndërtimin e

¹ Shkresa zyrtare me nr.K5/Y1-2prot., datë 29.02.2024 të institucionit të Avokatit të Popullit

çatisë së shtëpisë, vlerë kjo e mbuluar nga fondi i Emergjencave Civile.”²

Bazuar në përgjigjen zyrtare të sipërcituar dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile³, AP-ja i kërkoi informacion shtesë Bashkisë Skrapar duke i’u drejtuar me pyetje specifike si vijon:

- Sa është fondi i emergjencave civile në Bashkinë Skrapar për vitin 2023, 2024, 2025?
- Sa është vlera totale e investuar për rehabilitimin nga fatkeqësia natyrore për periudhën 2022, 2023?
- Këshilli bashkiak, a ka miratuar me vendim planin vendor për emergjencat civile? A është rishikuar ky plan cdo 3 vjet? A është ky plan i harmonizuar me planin kombëtar, planin e qarkut dhe planet vendore të bashkive fqinje⁴?
- Bashkia, a ka krijuar, administruar dhe përditësuar një bazë të dhënash për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë si pasojë e fatkeqësisë natyrore apo kanë ngelur të pastrehë?⁵

²Shkresa zyrtare me nr.769/1 prot., datë 03.04.2024 të Bashkisë Skrapar

³ Fondi i emergjencave të fatkeqësisë natyrore është një detyrim ligjor sipas nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” (ligji nr.45/2019) për bashkitë në vend. Ligji parashikon që çdo bashki të ndajë minimalisht 4% të buxhetit për emergjencat civile. *“Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë: a) nga të ardhurat e veta vendore; b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet; c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj. Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”* thuhet konkretisht në ligj

⁴Ligji 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 30 “Bashkitë”, pika 1/ ç) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi. Neni 14 “Planet për emergjencat civile”, pika 6,

⁵ Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 17/1/c): Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të kompetencave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile dhe për planifikimin dhe zhvillimin e territorit: c) krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit.

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/Y1-4 prot., datë 14.05.2024, “*Kthim përgjigje*” Bashkia Skrapar ka sqaruar si më poshtë vijon:

“...fondi i emergjencave civile i planifikuar për vitin 2023 ka qënë në vlerën prej 10 791 623 (dhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjatëqind e njëzetë e tre” lekë, në vitin 2024 është planifikuar në vlerën 11 428 427 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e njëzete shtatë) lekë dhe në vitin 2025 nga fondet e vetë bashkisë pa përfshirë fondin e mbrojtjes civile nga buxheti i shtetit është parashikuar në vlerën e 8 170 268 lekë (8 milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e tre) lekë. Fondi i emergjencave civile të shpenzuara për vitin 2022 ka qënë në vlerën prej 2 579 880 (dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetë dhjetë) lekë dhe për vitin 2023 ka qënë në vlerën 3 431 623 (tremilion e katërqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzetë e tre) lekë. Këshilli bashkiak me miratimin e buxhetit vjetor miraton fondin e emergjencës civile në total, dhe gjatë vitit rast pas rasti miraton me vendim të veçantë akordimin e fondeve nga emergjencat civile për individë apo familje në nevojë. Sektori i Emergjencave civile mban dhe përditëson të dhënat lidhur me familjet që kanë humbur familjarë si pasojë e fatkeqësisë natyrore por dhe që kanë banesa të dëmtuara si pasojë e shkaqeve natyrore.”⁶

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të sipërcituara të bashkisë Skrapar, AP-ja konstaton se ky institucion ka përmbushur proceduralisht zhvillimin e procesit sipas veprimeve si vijon:

- paraqitja e kërkesës nga Njësia Administrative Gjerbës për rikonstruksionin e banesës të dëmtuar së familjes Sulaj si pasojë e rreshjeve të shumta të shiut, si familje në nevojë⁷;
- nxjerrja e urdhërit për ngritjen e komisionit për verifikim të dëmeve të shkatuara nga fatkeqësi natyrore, në banesën e shtetasit Ymer Sulaj, fshati Zaloshnjë, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar⁸;

⁶ Shkresa zyrtare me nr.1515/1 prot. Datë 23.05.2024 të Bashkisë Skrapar.

⁷ Shkresa zyrtare me nr.102 prot., datë 13.11.2023 të Njesisë Administrative Gjerbës.

⁸ Urdhëri nr.488, datë 16.11.2023 “Për ngritjen e komisionit për verifikimin të dëmeve të shkatuara nga një fatkeqësi natyrore, në banesën e z.Ymer Sulaj, fshati Zaloshnjë, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar”.

- përpilimi i proces- verbalit të konstatimit të dëmeve të shkaktuara në të cilin citohet “...kjo banesë me gjendjen e krijuar mbas kësaj situatë është bërë e pabanueshme dhe nuk plotëson asnjë kriter për jetesë dhe mundësitë e saj (familjes) për të nderhyrë në riparimin e banesës apo gjetjen e një zgjidhje të përkohshme për të siguruar jetesën janë inekzistente...” dhe llogaritja e preventivit të vlerësimit të banesës së z.Ymer Sulaj në shumën prej 935 019 (nëntë qind e tridhjetë e pesë mijë nëntëmbëdhjetë) lekë;
- miratimi i vendimit nr.33, datë 23.11.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për fatkeqësinë natyrore në banesën e familjes së z.Ymer Sulaj, fshati Zaloshnjë, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar, ku është vendosur miratimi i dhënies së ndihmës financiare prej 300 000 (treqind mijë) lekë për fatkeqësinë e shkaktuar nga rreshjet e shumta të shiut në banesë nga fondi i Emergjencave Civile, parashikuar në buxhetin vjetor 2023, të Bashkisë Skrapar...”

Nga përmbajtja e dokumenteve të sipërcitura AP-ja konstaton se banesa e shtetasit Sulaj, babai i tre fëmijëve dy prej të cilëve kanë probleme të shëndetit mendor, është e pabanueshme. Shuma që duhet për riparimin e kësaj banese, referuar preventivit, është në masën 935 019 (nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë dhe ndihma financiare e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak për riparimin e banesës është në shumën prej 300 000 (treqind mijë) lekë nga fondi i Emergjencave Civile parashikuar në buxhetin vjetor 2023. AP-ja vlerëson ndihmën financiare të dhënë nga Bashkia Skrapar, megjithatë, mbështetja financiare që Bashkia Skrapar ka dhënë për riparimin e shtëpisë nuk është mjaftueshme për të bërë banesën të banueshme për familjen e z.Sulaj. AP-ja vë në dukje situatën vulnerabël të kësaj familjeje, ku 2 nga tre fëmijët e z.Sualj janë me probleme të shëndetit mendor.

Bashkia Skrapar sqaron se ka qënë në pamundësi financiare për ti dhënë familjes Sulaj të gjithë vlerën e parashikuar në preventiv. Nga shkresat e dërguara rezulton se fondi i emergjencave civile i planifikuar për vitin 2023 ka qënë në vlerën prej 10 791 623 (dhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjatëqind e njëzetë e tre” lekë dhe realizimi i këtij fondi ka qënë në masën 3 431 623 (tremilion e katërqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzetë e

tre) lekë, me përqindje fondi është realizuar me 32%⁹. Pra, Bashkia Skrapar nuk ka qënë në pamundësi financiare për të bërë të mundur dhënien e ndihmës financiare për rindërtimin e banesë së z.Sulaj nga fondet e Emergjencës Civile pasi për vitin 2023, fondi i planifikuar i Emergjencave Civile nuk është shpenzuar në masën 100%. AP-ja shpreh shqetësimin lidhur me mospërdorimin dhe kthimin e fondit të Emergjencës Civile sidomos për rastin në fjalë, kur fondi ka qënë i mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet për riparimin e shtëpisë së z.Sulaj.

AP-ja sjell në vëmendje të Bashkisë Skrapar se sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 14 të ligjit nr.45/2019, *“Planet për emergjencat civile marrin në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të shtresave në nevojë dhe grave.”*

Neni 41 parashikon dëmshpërblimin e çdo qytetari të prekur nga fatkeqësia natyrore. Dëmet përballohen nga vetë bashkitë dhe në rast se nuk kanë buxhet të mjaftueshëm, pagesa shtrihet në vitin pasardhës¹⁰.

AP-ja thekson se garantimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e tyre, në situata të emergjencave civile apo të fatkeqësive natyrore, në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore, duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Për të finalizuar përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të administratës publike në nivel vendor, për të garantuar mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave të fëmijëve, të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren institucionet përgjegjëse, duhet të udhëhiqen nga interesi më i lartë i tyre.

Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në jurisprudencën e saj për nenet 3 dhe 8, Gjykata theksoi rëndësinë për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të cënueshëm të shoqërisë që të përfitojnë nga mbrojtja e shtetit, kur mirëqenia e tyre fizike dhe mendore kërcënohej (*Wetjen dhe të tjerët kundër Gjermanisë, § 74, Tlapak dhe*

⁹Shkresa zyrtare me nr.1515/1 prot. Datë 23.05.2024 të Bashkisë Skrapar.

¹⁰ Neni 41 i ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” i ndryshuar.

të tjerët kundër Gjermanisë, § 87; A dhe B kundër Kroacisë, 2019, §§ 106-113). Një detyrim për t'u siguruar strehim individëve veçanërisht të cenueshëm/vulnerabël mund të rrjedhë nga neni 8 në raste të jashtëzakonshme (Yordanova dhe të tjerët kundër Bullgarisë, § 130). Në rastin e B.G. dhe të tjerët kundër Francës (2020), në lidhje me akomodimin e fëmijëve, Gjykata sqaroi se aktualisht ekziston një konsensus i gjerë – duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare – në mbështetje të idesë se në të gjitha vendimet në lidhje me fëmijët, interesat e tyre më të mira duhet të jenë parësore (§ 94).

Në këtë kuptim, në frymën edhe të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit në nivel vendor për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni dhe legjislacionit për mbrojtjen civile institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON :

- Marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Skrapar për mbështetjen me ndihmë financiare për rindërtimin e banesës së shtetasit Ymer Sulaj, fshati Zaloshnjë, Njësia Administrative Gjerbës, Bashkia Skrapar, në përputhje me zërat e parashikuar në preventivin e vlerësimit të banesës dhe fondit të emergjencave civile të planifikuar për vitin 2024, i cili është në shumën prej 11 428 427 lekë (njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e njëzete shtatë).
- Krijimin, administrimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave për individët dhe familjet që kanë mbetur të pastrehë, në territorin e Bashkisë Skrapar si pasojë e fatkeqësisë natyrore, duke evidentuar në mënyrë të posaçme fëmijët dhe familjet me fëmijë që kanë mbetur të pastrehë, si dhe masat përkatëse të marra hap pas hapi dhe ato që do të ndërmerren deri në sistemimin e plotë të tyre në banesë.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial, si dhe në funksion të përmbushjes së

detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ